



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E
MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE**

**TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:
KUALIFIKIMI PROFESIONAL
“DETARI”**

(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)

Tiranë, 2024

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve për Kualifikimin Profesional “**Detari**” me strukturë 2+1+1, për provimin e detyruar “**Teori profesionale e integruar**” të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së individëve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të individëve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmbljedhëse. Programi orientues për provimin e “**Teorisë profesionale të integruar**” bazohet në:

- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “**Detari**”, Niveli II i KSHK-së, referuar Niveli II në KEK, (klasa 10-të dhe 11-të);
- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “**Detari**”, Niveli IV i KSHK-së, referuar Niveli IV në KEK (klasa e 13-të).
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 27, datë 12.12.2023 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të individit.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e individëve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, si dhe analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të “Teorisë profesionale të integruar”, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e individëve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Qëllimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale është vlerësimi i të nxënësve dhe arritjeve, si dhe përzgjedhjen e individëve për arsimim të mëtejshëm.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar “**Teori profesionale të integruar**” të Maturës Shtetërore Profesionale të Kualifikimit Profesional “**Detari**”, është e rëndësishme që herë pas here mesimdhënësit të zhvillojnë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për Kualifikimin Profesional “**Detari**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht,

edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Ky program përmban rreth 30% të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve të kulturës profesionale. Në këtë program janë përfshirë ato lëndë, të cilat përbëjnë bazën kryesore dhe thelbësore për formimin profesional të individëve.

Individët duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**” në kuadrin e provimit të detyruar “**Teori profesionale e integruar**”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për Kualifikimin Profesional “**Detari**“, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

1. Njohuri për mjetet e lundrimit, kl. 10 dhe kl. 11
2. Lundrim, kl. 10, kl. 11 dhe kl. 13
3. Gjuetia në ujëra, kl. 10 dhe kl. 11
4. Ligjshmëri dhe organizim në detari, kl. 13:
5. Elektromekanika në anije, kl. 13:

Tabela 1: Lëndët profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë si më poshtë, duke konsideruar vëllimin dhe rëndësinë e tyre në formimin profesional të nxënësve.

Nr.	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Njohuri për mjetet e lundrimit	88	35
2	Lundrim	74	29
3	Gjuetia në ujëra	39	16
4	Ligjshmëri dhe organizim në detari	30	12
5	Elektromekanika në anije	21	8
	TOTALI	252	100%

Temat sipas lëndëve janë:

a) “Njohuri për mjetet e lundrimit”, kl. 10 dhe kl. 11:	(88 orë)
• Ndërtimi dhe materialet që përdoren për ndërtimin e anijes	10 orë
• Cimat, kavot dhe takilazhi në anije	12 orë
• Agregatet e instaluara në kuvertën e anijes	12 orë
• Familjarizimi me instrumentet dhe pajisjet kryesore navigacionale në urën e komandës së mjetit lundrues	4 orë
• Busulla magnetike, xhiroskopike, autopiloti	12 orë
• Instrumentet dhe pajisjet kryesore pneumatike dhe hidraulike	6 orë
• Instrumentet dhe pajisjet kryesore elektrike në mjetin e lundrimit	6 orë
• Sistemet tek motorët detarë	6 orë
• Pompat, kompresorët, kaldaja, impiantet ftohëse, etj.	8 orë
• Tanket, sentinat dhe sistemet e tubacioneve në anije	6 orë
• Markimet dhe simbolet në kuvertë, hotel dhe makineri	6 orë

b) “Lundrim”, kl. 10 dhe kl. 11:	(74 orë)
• Vetitë lundruese të anijes	6 orë
• Sistemi i lëvizjes dhe i drejtimit të anijes	6 orë
• Rëndësia e familjarizimit me sektorin e kuvertës. Hyrjet, daljet, agregatet, vendet e punës, pajisjet e ngarkim-shkarkimit, hapësirat e ngarkesës, hotelin, kabinën, mjetet e komunikimit të brendshëm, etj.	2 orë
• Detyrat e shërbimit në urën e komandës. Telegrafa.	3 orë
• Rëndësia e familjarizimit me sektorin e makinerisë pajisjet, agregatet, hyrje/daljet, vendet e punës, komunikimi me urën e komandës, vendet e dhënies së alarmit, etj.	2 orë
• Sigurimi i ngarkesës në mjetin e lundrimit, mjetet, pajisjet dhe procedurat	4 orë
• Rregulla për parandalimin e përplasjeve të anijeve në det	12 orë

b²) “Lundrim detar”, kl. 13	
• Shtrimi grafik, përcaktimi i vendndodhjes, hedhja e të dhënave lundrimore	4 orë
• Organizim i punës, shërbimit dhe pushimit në bord IMO, FAO & ILO	3 orë
• Ndërtimi, stabiliteti dhe kontrolli i tij në raste dëmsh	12 orë
• Manovrim anije	6 orë
• Komunikimi detar, legjislacioni dhe institucionet (IMO Model 1.26)	10 orë
• Kërkim shpëtimi në det	4 orë

c) “Gjuetia në ujëra” kl. 10 dhe kl. 11:	(39 orë)
• Teknika e gjuetisë në ujërat detare	4 orë
• Materialet e fijëzuara në veglat e gjuetisë	6 orë
• Rrjetat dhe pëlhurat. Përdorimi i tyre në veglat e gjuetisë	6 orë
• Jetëgjatësia e materialeve dhe veglave të peshkimit	2 orë
• Parimet e përzgjedhjes së veglës së peshkimit në raport me gjuetinë e synuar	2 orë
• Vetitë fizike të ujit	4 orë
• Parimet e ruajtjes së rezervave të peshkut	4 orë
• Sëmundjet e peshqve. Efektet e ujërave të kontaminuar	5 orë
• Të tregojë rregullat e ndërhyrjes për ruajtjen e cilësisë dhe freskisë së peshkut gjatë transportimit	6 orë
d) “Ligjshmëri dhe organizim në detari” kl. 13:	(30 orë)
• Organizimi, kontrolli e ligjshmëria e hapësirës detare. Funkcionet e QNOD	4 orë
• Zyra e Regjistrimit të mjeteve lundruese dhe detarëve	2 orë
• Shoqëria e Klasifikimit të mjeteve lundruese	2 orë
• IMO, ILO, FAO, OKB, BE, Marrëveshje Rajonale & Ndërkufitare	7 orë
• Strategjia e peshkimi. Kushtet dhe zonat e lejuara. Inspektorati i peshkimit.	3 orë
• Kodi i Hetimit të Aksidenteve & Incidenteve Detare të IMO-s	4 orë
• Siguracioni Detar	5 orë
• Plani Kombëtar i reagimit ndaj ndotjeve masive detare	3 orë
e) “Elektromekanika në anije”, kl. 13:	(21 orë)
• Mirëmbajtja e motorëve detar	3 orë
• Mirëmbajtja e makinerisë ndihmëse përfshirë (pompa, tubacione, kaldaja, sisteme drejtimi, etj.	4 orë
• Mirëmbajtja e impianteve të energjisë	3 orë
• Mirëmbajtja e sistemeve të ftohjes	2 orë
• Mirëmbajtja e sistemeve hidraulike, pajisje gjuetie e agregate kuverte	3 orë
• Mirëmbajtja dhe testimi i pajisjeve elektrike	2 orë
• Riparim dokimi, detyrat, mjetet, pajisjet, kushtet e punës, plani i punës	2 orë
• Kryerja e shërbimit në lundrim në lokalitë e makinerisë	2 orë